



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**VENDIM**  
**Nr. 18, datë 17.07.2020**

**PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZONJËS VJOSA BODO (MUJO) NË VENDIN VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS NË DATËN 28.08.2018 DHE RISHPALLUR NË DATËN 21.08.2019**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

<b>Vitore Tusha</b>	- Zëvendëskryetare
<b>Fiona Papajorgji</b>	- Anëtare
<b>Arta Marku</b>	- Anëtare
<b>Miranda Andoni</b>	- Anëtare
<b>Saida Dollani</b>	- Anëtare/Relatore
<b>Ludovik Dodaj</b>	- Anëtar
<b>Fatjona Memçaj</b>	- Anëtare
<b>Arjan Qafa</b>	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e Avokates së Popullit, **znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësues i autorizuar i Presidentit të Republikës,

- **znj. Katrin Treska**, përfaqësuese e autorizuar e Presidentit të Republikës,

- **në mungesë të përfaqësuesve të tjerë** të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje,

në mbledhjen e datës 17.07.2020, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATI PËR GJYQTAR  
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

**Znj. Vjosa Bodo (Mujo)**

**OBJEKTI:**

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të **znj. Vjosa Bodo (Mujo)**, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datë 21.08.2019.

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **Saida Dollani**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si e bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të nenit 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000), Kuvendi i Republikës, në datën 28.08.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim të procedurës së verifikimit të kandidaturave, me vendimin nr. 115, datë 09.08.2019, vendosi:

- Njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

3. Në zbatim të vendimit nr. 115, datë 09.08.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të nenit 125 të Kushtetutës dhe të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, Kuvendi i Republikës, në datën 21.08.2019, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.

4. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

5. Në vijim nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me vendimin nr. 136, datë 21.09.2019, u vendos:

- Fillimi i procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019.

6. Në zbatim të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim ligji nr. 115/2016) dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2, datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe



të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 21.09.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për vendin vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

7. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datë 21.08.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtari i Këshillit, z. Fatri Islamaj. Gjatë zhvillimit të procedurave të verifikimit për këtë pozicion vakant, rezulton se relatori Fatri Islamaj me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në datë 10.12.2019 është shkarkuar nga detyra. Në kushtet kur ligji parashikon pezullimin e menjëhershëm nga detyra të gjyqtarit, për shkak të këtij vendimi Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datë 11.12.2019 ka realizuar përsëri shortin manual. Sipas shortit, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Vitore Tusha. Për shkak të përfundimit të mandatit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm) 2019, zhvillimi i procedurave të verifikimit për këtë pozicion vakant i kaluan Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 2020, i cili në datë 15.01.2020 zhvilloi shortin manual dhe relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Saida Dollani.

8. Znj. Vjosa Bodo (Mujo), si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Vjosa Bodo (Mujo), gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

9. Në datën 25.09.2019, kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

10. Në datën 30.09.2019 sipas datës së postës dhe administruar pranë KED në datë 02.10.2019, kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formular të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

11. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr.548 prot., datë 04.10.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.



12. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Vjosa Bodo (Mujo), ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

13. Me shkresën nr.4186/1 prot., datë 14.10.2019, ILDKPKI-ja ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

14. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim ligji nr. 9049/2003) dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim ligji nr. 9367/2005), me shkresën nr.116/25 prot., datë 05.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Vjosa Bodo (Mujo) dhe personat e lidhur me të.

15. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkitimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatës Vjosa Bodo (Mujo) dhe personave të lidhur me të.

16. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatës Vjosa Bodo (Mujo), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 09.10.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka Intesa Sanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka Procredit, (9) Banka Raiffeisen, (10) Banka Societe Generale, (11) Banka Tirana dhe (12) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Tirana Factoring & Lease, (15) Tranzit sha, (16) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit



Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.

ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

17. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 16 më sipër, me përjashtim të Banka Alpha Albania, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Vjosa Bodo (Mujo).

18. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr.603 prot., datë 09.10.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (në vijim ligji nr. 138/2015).

19. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 2690/113 prot., datë 21.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Vjosa Bodo (Mujo).

20. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidates Vjosa Bodo (Mujo), në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve, Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr.602 prot., datë 09.10.2019) dhe me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr.604 prot., datë 09.10.2019).

21. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat nr. 3778 prot., datë 21.11.2019, si dhe nr. 2155 prot., datë 22.10.2019 e nr. 2050/2 prot., datë 28.10.2019.

22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 45/2015), si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 601 prot., datë 09.10.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.



23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.1386/4 prot., datë 25.10.2019, ka dërguar vendimin nr. 671, datë 25.10.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Vjosa Bodo (Mujo).

24. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave "b", "c" dhe "d" të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 237 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91 e 93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

25. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "c" e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli në datën 16.10.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, partitë politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Vjosa Bodo (Mujo).

26. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi t'i drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekte private, pranë të cilave kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit si: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (*shkresa nr. 661 prot., datë 15.10.2019*), Departamenti i Administratës Publike (*shkresa nr. 657 prot., datë 15.10.2019*), Shoqëria SICRED sh.a (*shkresa nr. 662 prot., datë 15.10.2019*).

27. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (*shkresa nr. 8931/1 prot., datë 29.10.2019*), Departamenti i Administratës Publike (*shkresa nr. 6095/1 prot., datë 23.10.2019*), Shoqëria SICRED sh.a. (*shkresa nr. 2725/1 prot., datë 24.10.2019*).

28. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "a" e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatët të kenë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, është shqyrtuar dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, si dhe shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit.

29. Këshilli i ka kërkuar kandidatit të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë në zbatim të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 si dhe në zbatim të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, i është kërkuar informacion për:

1- *Pozicionet e punës së deklaruar nga ana juaj, a mundet që të barazohen me atë në kuptim të nenit 7/a i Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese"?*



30. Kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka paraqitur me shkrim shpjegime dhe dokumente shtesë pranë Këshillit me e-mailin e datës 12.11.2019.

31. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", anëtari i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

32. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", zv/Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2020, ora 13 e 30, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e ndalimit të kandidimit të znj. Vjosa Bodo (Mujo), për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datë 21.08.2019.

33. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatës Vjosa Bodo (Mujo), nëpërmjet postës elektronike zyrtare, në datën 13.07.2020.

34. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

35. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2020, ora 13 e 30, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

36. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

37. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatës Vjosa Bodo (Mujo).

38. Avokati i Popullit parashtrroi se ishte dakord në thelb me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidatës dhe ka sugjeruar disa elemente shtesë që duhet të përmbajë në të ardhmen relacioni në lidhje me përcaktimin e kohës së veprimeve (të përfundimit të hetimit prej relatorit apo të komunikimit të gjetjeve kandidatit). Po ashtu, sugjeroi që në drejtim të verifikimit të kriterit ndalues që lidhet me pasjen e pozicioneve drejtuese në parti politike të komunikohet në të ardhmen edhe me KQZ-në.

## II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

39. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI-ja, me shkresën nr.116/25 prot., datë 05.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatën Vjosa Bodo (Mujo) dhe personat e lidhur me të.

40. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatës Vjosa Bodo (Mujo), ILDKPKI-ja në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.
- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
- ç) Nuk ka kryer deklarin të rremë.
- d) Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

41. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI-së, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi. Këshilli vlerësoi se, edhe pse Alpha Bank nuk i ka kthyer përgjigje Këshillit, rezulton se kjo bankë i ka kthyer përgjigje ILDKPKI-së dhe nuk rezulton që për këtë kandidatë të ketë të dhëna financiare që ndikojnë në konkluzionet e ILDKPKI-së.

42. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshilli i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklarin e bëra nga kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) pranë ILDKPKI-së me *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë*.

43. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaures, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI-ja, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatës Vjosa Bodo (Mujo).

44. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së saj personale dhe të familjarëve të saj”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, **kjo kandidatë nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.**

45. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 2690/113 prot., datë 21.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatën Vjosa Bodo (Mujo), duke ardhur në përfundimet se:



a) Subjekti deklaruës Vjosa Bodo (Mujo), nuk përfshihet në fushën e veprimtimit të nenit 2 të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

46. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.1386/4 prot., datë 25.10.2019, ka dërguar vendimin nr. 671, datë 25.10.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Vjosa Bodo (Mujo), duke ardhur në përfundimet se:

a) Për zonjën Vjosa Bodo (Mujo), nga verifikimet e kryera deri tani nuk figuron të ketë materiale në dokumentet të ish- Sigurimit të Shtetit në emër të saj, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

47. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr. 2155 prot., datë 22.10.2019 dhe nr. 2050/2 prot., datë 28.10.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar, të cituara në pikën më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Vjosa Bodo (Mujo):

a) Nuk figuron e evidentuar për veprimtari kriminale.

48. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 3778 prot., datë 21.11.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara në pikën më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Vjosa Bodo (Mujo):

a) Në përfundim të procedurave të verifikimit, nuk disponohen të dhëna/informacione që bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 89 gërmat “a” dhe “c” për integritetin e figurës së znj. Vjosa Bodo (Mujo).

49. Nisur nga rezultatet si më sipër, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo), në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, **nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.**

50. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 237 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidati ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të tij.

51. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1997- 2001 si Jurist, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik,

Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë **kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.**

52. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, sikurse parashtrohet në pikën më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara.* Këshilli konstaton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Për rrjedhojë **kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.**

53. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondenca me partitë politike,* Këshilli konstaton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë **kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.**

54. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.* Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që ajo të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë **kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.**

55. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatët *të kenë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike,* nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka ushtruar veprimtari profesionale si:

a) Sekretare pranë zv. Ministrit, për periudhën “21.01.2002 – 16.05.2002”, pranë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Tiranë.

b) Sekretare pranë Sekretarit të Përgjithshëm, për periudhën “16.05.2002 – 16.04.2004”, pranë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Tiranë.

c) Specialiste, për periudhën “16.04.2004 – 03.Mars 2009”, pranë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Tiranë.

ç) Juriste pranë Departamentit Juridik dhe Burimeve Njerëzore, për periudhën “12.03.2009 – 10.05.2011”, pranë subjektit tregtar SiCRED sh.a.

d) Drejtor pranë Departamentit Juridik dhe Burimeve Njerëzore, për periudhën “10.05.2011 e në vijim”, pranë SiCRED sh.a.



56. Në komentet e paraqitura me shkrim nga kandidatja Vjosa Bodo (Mujo), me e-mailin e datës 12.11.2019, në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Këshilli nëse pozicionet e punës së deklaruar prej saj plotësojnë kërkesën e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, ajo ka parashtruar si më poshtë:

1- Rezulton e provuar se unë kam përfunduar studimet e larta dega Drejtësi në Universitetin Shtetëror të Tiranës dhe jam diplomuar në vitin 2001, duke marrë titullin "Jurist". Jam atashuar pranë studios ligjore të znj. Zana Hasko, dhe më pas kam kryer provimin shtetëror të avokatisë, me të cilin kam marrë titullin "Avokat", licenca nr. 1731 – nëntor 2002. Kjo e drejtë e fituar prej meje, nuk është revokuar asnjëherë dhe si e tillë, vlen dhe ecën për efekt vjetërsie në kuptim të kërkesave të nenit 7/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000.

2- Në vitet e provuara të punës sime pranë Ministrisë së Transporteve, vlej në për efekt vjetërsie periudha e punës nga 16-04-2004 deri në 20 -03-2009, periudhë në të cilën kam qenë nëpunës civil. Kjo periudhë është kumuluese sipas kuptimit tim me vjetërsinë në total të viteve të eksperiencës sime në punë dhe në kuptimin që duhet të përfitojë meritat e të qenurit në epitetin kushtetues "jurist i nivelit të lartë". Në këtë pozicion, kam pasur si detyrë funksionale identifikimin dhe propozimin e krijimit të akteve ligjore edhe nënligjore, propozimin dhe draftimin e përmirësimit të akteve që rregullojnë dhe normojnë veprimtarinë e transportit ajror, si specialistja e vetme në gjithë organogramën e administratës shtetërore të Republikës së Shqipërisë që mbuloja këtë fushë.

3- Pavarësisht diferencës që ligjvënësi ka vendosur për dikastere të veçanta të administratës qendrore, duke klasifikuar kryesisht, juristët e Kuvendit të Republikës, juristët e Këshillit të Ministrave apo ato të Drejtorisë së Kodifikimit të Ministrisë së Drejtësisë si juristë të një kualiteti të veçantë/të spikatur, për qëllime të këtij komunikimi, me duhet të qartësoj se kontrolli për teknikë legjislativë dhe kushtetueshmëri që kryejnë këto hallka mbi tekstin e propozuar ligjor nga ministritë e linjës, nuk mundet apriori të deduktojë që juristët propozues të aktit janë më pak kualitativë se juristët që kanë ndërtuar apo përshtatur aktin, në kuadër të zhvillimit të një politike të një sektori të veçantë.

4- Dua të qartësoj se puna si eksperte në drejtorinë e politikave të transportit ajror më ka spikatur. Duke ju referuar akteve me karakter ligjor apo nënligjor që janë prodhuar në harkun kohor 2004-2009 me propozim të ardhur drejtpërdrejt nga drejtoria e politikave të transportit ajror, nëpërmjet propozimit të ministrit të linjës, Ministrit të Transporteve, ndër të cilat një pjesë e mirë e akteve janë edhe transpozim i "aquis comunitare", më japin avantazhin e padyshueshëm si jurist i spikatur gati unik në llojin e tij.

5- Nën petkun e juristit kam realizuar punën thelbësore në materializimin e aktit si draft, si më poshtë:

a- Ligji nr. 9281, date 23-09-2004, kam qenë pjesë e grupit të punës në ndërtimin e këtij akti ligjor.

b- Ligji nr. 9251, datë 08-07-2004, pjesë e grupit të punës për ndërtimin e këtij akti ligjor.

c- Ligji nr. 9255, datë 15-07-2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për unifikimin e disa rregullave për transportin ajror ndërkombëtar".

d- Ligji nr. 9312, datë 11.11.2004, që miraton kontratën koncesionare të aeroportit të vetëm ndërkombëtar që operon në RSH.

a- Anëtare e grupit që ka ndihmuar z. Henrich Hegemann, avokat të përfaqësues palën shqiptare në arbitrazh, pranë dhomës ndërkombëtare të tregtisë në Paris, lidhur me shoqërinë BEHASE. (VKM 143, date 19-04-2002).

a- Ligji që miraton rregullimin e transportit ajror ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe Shtetit të Ukrainës, pjesë e grupit negociues në Ukrainë.

b- Ligji që miraton rregullimin e transportit ajror ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe Shtetit të Izraelit.

c- VKM nr. 492, datë 30-06-2005 "Për caktimin e tarifave ajrore".

d- VKM nr. 480, date 23-06-2005 që konfirmon miratimin e projekt-kontratës ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Lockheed Martin Global inc.

e- Ligji 9658, datë 18.12.2006, që miraton marrëveshjen shumëpalëshe, pjesë e grupit negociues në Bruksel.

f- Kodi Ajror i RSH ligji Nr. 10 040, datë 22.12.2008.

g- VKM nr. 14, datë 7.1.2009 “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave për regjistrimin ndërkombëtar”.

h- VKM nr. 548 datë 29.08.2007, botuar në fletoren zyrtare 117 datë 10/09/2007.

6- Të gjitha këto angazhime, të cilat kanë konkluduar në prodhimin e akteve konkrete ligjore, ligje, apo vendime qeverie, apo përfaqësime sipas porosisë, reflektojnë më së miri angazhimin dhe eksperiencën time për të kryer në harkun kohor të 5 viteve punë detyrën e lartë të juristit të spikatur në një fushë dhe disiplinë të caktuar të transportit dhe jo vetëm.

7- Pavarësisht faktit që dispozita kushtetuese kërkon eksperiencën në 15 vite të provuar me dokumente mbështetëse së paku në njërën nga kriteret alternative të cituara, arsyetoj që kriteri i viteve në profesionin e një avokati, nuk mund të minusohet vetëm nga kriteri i viteve për të cilat ka qenë aktiv në regjimin tatimor.

8. Unë kam provuar me fakte evidente sipas kuptimit të ligjit që në 5 vite (prill/2004 – mars/2009) kam qenë jurist i spikatur i administratës shtetërore, jo vetëm në industrinë e aviacionit civil dhe të drejtës së saj, por edhe në disiplinat e së drejtës detare dhe atë rrugore.

9. Vitet e punës në sektorin privat nga marsi i vitit 2009 e aktualisht, janë një tjetër sfidë të cilën besoj se e kam fituar me faktin që kam qenë aktive në përmirësimin ligjor, por edhe nëpërmjet formave ligjore kontraktuale të disa industrive të dallueshme e tërësisht të zhvilluara në 10 vitet e fundit, në të drejtën shqiptare.

57. Bazuar në gjetjet e cituara si më sipër, Këshilli konstaton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) **nuk ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.**

58. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se:

**“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.**

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”.

59. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, parashikohet se:

**“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:**

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;



- c) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) **të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;**

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

60. Në kuptim dhe zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të lartpërmendura, nisur nga të dhënat mbi kohëzgjatjen dhe llojin e veprimtarisë profesionale të ushtruar, Këshilli konstaton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka një përvojë pune prej 10 vjet e 5 muaj si juriste dhe si drejtore e departamentit juridik pranë SICRED sh.a.. Kjo eksperiencë konsiderohet nga Këshilli si eksperiencë pune në sektorin privat, ndërkohë që Kushtetuta dhe ligji nr. 8577/2000, parashikojnë si kusht eksperiencën e punës në administratën publike. Këshilli vlerëson se duke mos marrë në konsideratë periudhën e kohës pranë sektorit privat, si dhe atë si sekretare, kandidatja nuk plotëson kushtin e vjetërsisë në punë për të qenë kandidate për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, pasi ka më pak se 15 vjet përvojë pune në pozicionet e kërkuara nga neni 125 i Kushtetutës dhe neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000. Për këtë arsye, Këshilli nuk e sheh të nevojshme të arsyetojë nëse periudha kur kandidatja ka ushtruar për 5 vjet funksionin e specialistes pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Tiranë (16.04.2004 – 03.03.2009), për shkak të detyrës së kryer, hyn në kategorinë e juristes së nivelit të lartë. Nga ana tjetër, pasja e titullit “Avokat” që prej vitit 2002, nuk vlerësohet prej Këshillit si eksperiencë profesionale në kuptim të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, për sa kohë që nga dokumentacioni i paraqitur dhe i administruar prej Këshillit, nuk rezulton që kandidatja të ketë ushtruar efektivisht këtë profesion.

61. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidates Vjosa Bodo (Mujo), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019, pasi kjo kandidate nuk plotëson kriterin e përvojës në punë.

## PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d dhe nenit 125 të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/c të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shumicë votash,

## VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatës Vjosa Bodo (Mujo), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Vjosa Bodo (Mujo).
3. Kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZV/KRYETARE

Vitore TUSHA





## MENDIM PAKICE

Në cilësinë e anëtares së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kam votuar kundër vendimit të marrë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me **nr.18, datë 17.07.2020** për ndalimin e kandidimit të kandidatës znj. Vjosa Bodo(Mujo), e cila ka shprehur interes për vendin vakant të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018, dhe rishpallur në datën 21.08.2019. Në respekt të nenit 47 të Vendimit nr. 4/2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”* të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, paraqes sa më poshtë mendimin tim në pakicë kundër këtij vendimi.

Kam vlerësuar se duhet të procedohej me vendim për lejimin e kandidimit të kandidatës Vjosa Bodo (Mujo) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të rishpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 21.08.2019, ndryshe nga sa konkluduar shumica, pasi nga ana e saj plotësohen të gjitha kushtet dhe kriteret e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, duke përfshirë këtu edhe kriterin e përvojës së punës. Kam arritur në këtë konkluzion duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatës Vjosa Bodo (Mujo), të administruara gjatë procedurës për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës parashikohet se :

*“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*

*5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”*

Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”* parashikohet se:

*“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:*

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral”.

Referuar pikës 4 të nenit 125 të Kushtetutës, kandidati që kërkon të zgjidhet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ndërmjet të tjerave duhet të plotësojë kushtet që lidhen me:(a) 15 vjet përvojë pune, dhe (b) ushtrimin e kësaj përvoje si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike. Ndërsa pika 5, e nenit 125 të Kushtetutës ka njohur rezervën ligjore absolute të Kuvendit për të rregulluar me ligj, “Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese”. Kështu, mbi këtë delegim kushtetues, ligjvënësi, në nenin 7/a të ligjit nr.8577/2000(i shtuar me ligjin nr.99/2016), të titulluar “Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese”, dhe nenin 240 të ligjit nr.115/2016 ka përcaktuar kritere të tjera ligjore, mbi të cilat do të kryhet verifikimi i kandidaturave, por edhe renditja e tyre në bazë të meritave të tyre profesionale, morale, organizative, drejtuese dhe menaxheriale. Duke ju referuar parashikimeve ligjore që gjenden në këto dispozita, konstatohet lehtësisht se ligjvënësi, brenda pushtetit të tij të deleguar nga Kushtetuta, ka renditur shumë kritere të tjera, referuar kushteve bazë që Kushtetuta ka parashikuar për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese.

Në pamje të parë të krijohet pershtypja se ligjvënësi në nenin 7/a të ligjit nr.99/2016 me frazën “jurist i nivelit të lartë në administratën publike” ka krijuar një kundërshti me formulimin e bërë në Kushtetutë, në pikën 4 të nenit 125, me frazën “nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike”, por siç është shprehur edhe më përpara Këshilli në vendimet e tij nr. 102, 103, 104 dhe 105, të datës 30.07.2019, “...Kushtetuta dhe ligji nuk kanë patur për qëllim as të konfundojnë kuptimin që i duhet dhënë, por as të keqzbatojnë përdorimin e këtij termi”.

Kështu, në vlerësimin tim, qëllimi primar që kërkon Kushtetuta dhe ligji, është ai i pluralitetit të përvojave të mëparshme të punës në radhët e gjyqtarëve kushtetues, veprimtaria e tyre e spikatur në fusha të ndryshme të së drejtës në sektorin publik dhe/ose privat, të cilat sigurojnë edhe prurjen e vlerave të posaçme dhe gjithanshme profesionale, por edhe një ekuilibër kushtetues dhe mundësi të barabarta mes juristëve. Pikërisht nisur nga ky qëllim i kushtetutbërësit, nuk mund të pranohet që fraza kushtetuese “nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike”(neni 125/4) të njehsohet me frazën “nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese”, që parashikohet në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, dhe që togfjalëshi “administratë publike” të njehsohet me “administratë në sektorin joprivat”.

Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, siç përcakton në pikën 2 të nenit 1 të tij, rregullon marrëdhënien juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit të tij dhe përcakton rregullat për administrimin e shërbimit civil. Fusha e zbatimit të tij është e kufizuar dhe e mirëpërcaktuar. Faza “administratë publike” nuk ka pse të njehsohet me njësitë institucionale qeveritare, që rregullojnë funksionimin e shoqërisë. Fjala “publike” që plotëson fjalën “administratë” apo “administrim” shërben për të kuptuar se kjo e fundit në vetvete ka një kuptim më të gjerë atë të veprimtarisë se çdo entiteti që ka për qëllim t’u shërbej interesave të përgjithshme, të popullsisë dhe të kolektivitetit.



Në doktrinën juridike bashkohore janë evidentuar dy qasje mbi te kuptuarit e “*administratës publike*”: një konceptim i gjerë, që konsideron pjesë të administratës edhe organizmat private të ngarkuara me një veprimtari administrative, dhe një konceptim i ngushtë, që i përjashton ato. Në gjuhën shqipe termi “*administrata publike*” nuk ka pse të dallohet nga termi “*administrimi publik*”, në gjuhë të tjera, nga ku edhe është huazuar, për të dy këto nocione përdoret i njëjti term: “*publik administration*” (anglisht), “*administration publique*” (frëngjisht), “*amministrazione pubblica*” ose “*pubblica amministrazione*” (italisht). Termi “*public administration*” ka një kuptim të dyfishtë; në kuptimin objektiv termi përcakton tërësinë e aktiviteteve të kryera që u përgjigjen nevojave të një interesi të përgjithshëm të popullsisë (rendi publik, tregu i shërbimeve publike, etj), ky kuptim lidhet me funksionin publik (funksioni administrativ); në kuptimin subjektiv është një tërësi subjektsh që ushtrojnë funksionin e mësipërm.

Në gjykimin tim këtë përkufizim të zgjeruar ka patur në vlerësimin e tij edhe kushtetutbërësi. Ai ka përfshirë specifikisht në një ndër përvojat e punës, që duhet të ketë kandidati, edhe atë të noterit dhe avokatit që sipas së drejtës sonë janë pjesë e shërbimit publik, pavarësisht se ushtrojnë funksionet e tyre në sektorin privat, apo edhe profesorët e se drejtës, të cilët veprimtarinë e tyre mund ta ushtrojnë në sektorin privat apo shtetëror.

Nisur nga një interpretim i tillë i zgjeruar i normës kushtetuese në vendimet nr. 102, 103, 104, dhe 105, të datës 30.07.2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi elaboroi se “...*formulimi “jurist i nivelit të lartë në administratën publike, që ka përdorur ligjvënësi në nenin 7/a, pika 2 të ligjit nr.99/2016 është në të njëjtin synim dhe orientim që ka norma kushtetuese për përfshirjen në Gjykatën Kushtetuese të atyre juristëve të administratës publike, të cilët kanë treguar një nivel të lartë të profesionalizmit dhe që do i shërbejnë cilësisë së vendimmarrjes së Gjykatës, si autoriteti më i lartë në Republikën e Shqipërisë, e cila bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese”.*

Mbi këtë këndvështrim vlerësoj se Kushtetuta nuk ka patur si qëllim që në Gjykatën Kushtetuese të përfshijë vetëm ata juristë të cilët janë emëruar të drejtojnë nivelet më të larta të administratës shtetërore, por ata juristë që me veprimtarinë e tyre kanë demonstruar njohje dhe interpretim shumë të mirë të ligjeve, që në një të nesërme mund të bëhen konflikt kushtetues, qofshin subjekte private apo publike si palë në këto konflikte. Pikërisht për këtë, mbi të njëjtin qëndrim që kam mbajtur edhe në vendimmarrjet e mëparshme të Këshillit, për të vlerësuar spikatjen e kandidatit me vlera të larta profesionale në fushën e së drejtës publike, gjykoj që nuk mund të shërbejë përfshirja dhe/ose klasifikimi i tij/i saj në pozicionet e shërbimit civil shtetëror sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit, por vetëm aftësia dhe performanca e tij në ushtrimin e detyrave në shërbim të publikut në disiplina të ndryshme të së drejtës publike.

Mbështetur në interpretimin sa më sipër të frazës “*jurist të nivelit të lartë në administratën publike*” dhe “*administratë publike*”, unë vlerësoj së kandidatja Vjosa Bodo(Mujo) ka për së paku 15 vite përvojë punë pranë një organizmi shtetëror dhe privat që sipas legjislacionit shqiptar kryen shërbim publik, përvojë punë kjo që përfshihet në atë të “*juristit të nivelit të lartë në administratën publike*”, nisur nga natyra dhe lloji i detyrave që ka kryer, të cilat ajo i ka specifikuar në përgjigjet që i ka dhënë Këshillit, dhe aktet e depozituara pjesë e dosjes së saj. Prandaj unë vlerësoj se ndryshe nga sa është shprehur shumica, kandidatja Vjosa Bodo(Mujo) ka plotësuar edhe kriterin e parashikuar në pikën 4, të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr.8577/2000.

Sa më sipër, duke u bazuar në tërësinë e gjetjeve dhe të dhënave të konstatuara gjatë procedurës së verifikimit, të cilat kanë rezultuar nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidates, në interpretim dhe në zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vij në përfundimin se duhej të vendosej lejimi i kandidimit të kandidatës Vjosa Bodo(Mujo), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019

**ANËTARE**

**Fatjona MEMÇAJ**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Fatjona Memçaj', written over the printed name.



## MENDIM PAKICE

Anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, SAIDA DOLLANI, sipas nenit 47 të Vendimit nr.4/2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në motivet kundër vendimit të marrë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me nr.18, datë 17.07.2020 për ndalimin e kandidimit të znj. Vjosa Bodo (Mujo) për pozicionin e Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Duke votuar për lejimin e kandidimit, të kandidatës Vjosa Bodo (Mujo), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019, në vijim ekspozoj argumentat e mendimit në pakicë.

1. Referuar vendimit të shumicës, është e qartë se Kandidatja Vjosa Bodo është ndaluar për mosplotësimin e **kriterit të meritës profesionale** prej 15 vjet përvojë pune si gjyqtare, prokurore, avokate, profesore ose lektore të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

2. Pakica vlerëson se duke u parashikuar merita profesionale prej ‘**15 vjet përvojë pune**’ si kriter (pra jo si kusht ligjor) nga neni 7/a pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, **shqyrtimi i meritës profesionale nuk i përket fazës së verifikimit por i përket fazës së mëvonshme, asaj të vlerësimit.**

3. Neni 149/d i Kushtetutës së Republikës parashikon në mënyrë eksplicite në pikën 1, se: ‘**1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati**’.

4. Pikërisht, në bazë të këtij parimi Kushtetues, ligjvënësi i zakonshëm ka nxjerrë ligjin nr. 115/2016 ‘Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë’, Pjesa V e të cilit i dedikohet Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të cilin neni 218 pika 1 e ligjit nr. 115/2016, përcakton se: ‘**Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është organ i pavarur që verifikon përmbushjen e kushteve ligjore dhe vlerëson kriteret profesionale e morale të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë**’.

5. Pjesa V e ligjit nr. 115/2016 ndahet në gjashtë Krerë, ku Kreu IV parashikon rregullat për verifikimin e kushteve ligjore të kandidatëve ndërsa Kreu V parashikon vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve. Nga leximi i normave në mënyrë koherente qartësisht vërehet se veprimtaria e vlerësimit të kandidatëve për vendet e lira në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë kalon nëpër dy faza:



**a) Faza e parë është ajo e verifikimit të kushteve** ligjore të kandidatëve për të cilat parashikojnë rregullat e neneve 234-238 të ligjit nr. 115/2016 si dhe rregullat nënligjore të parashikuara në vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.

**b) Faza e dytë është ajo e vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve**, për të cilat parashikojnë rregullat e neneve 239-240 të ligjit nr. 115/2016 si dhe rregullat nënligjore të parashikuara në vendimin nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.

6. Rrjedhja llogjike –juridike e arsyetimit të paragrafëve të mësipërm është se në fazën e verifikimit të kushteve ligjore Këshilli verifikon vetëm kushtet e përcaktuara në nenet 234, 235, 236, 237 të ligjit 115/2016 si dhe kushtet e parashikuara nga neni 7/a pika 1 e ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar, tek i cili referon në mënyrë të shprehur ligji nr. 115/2016. Nëse kandidatët kanë sukses në plotësimin e kushteve ligjore, pra pas përfundimit të procedurës së verifikimit, sipas parashikimeve të neneve 234 deri në 238, të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vijon me vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve dhe bën renditjen e tyre (neni 239 i ligjit 115/2016).

7. Në një arsyetim analitik, - i përcaktuar jo vetëm nga renditja në mënyrë eksplicite e kushteve dhe rrjedhoja e përmbushjes së tyre apo pasoja e mospërmbushjes së tyre, por edhe nga formulimi i pikës 4 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016, - duke përballur faktet e gjetura me të drejtën e parashikuar nga dispozitat e sipërcituara qartësisht verifikohet se kandidatja Vjosa Mujo (Bodo) plotëson kushtet ligjore, tashmë të arsyetuara edhe nga vendimi i shumicës, por për efekt të lehtësisë së mendimit kundër po ekspozohen edhe nga pakica, si vijon:

8. Në mënyrë eksplicite parashikon ligji nr. 115/2016 që me t`u vënë në lëvizje nga Subjektet e parashikuar në nenin 234 të ligjit, **kushti i parë për t`u verifikuar nga Këshilli, është kontrolli i pasurisë.** Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, lidhur me deklarinimin e pasurisë dhe interesave private të kandidates Vjosa Bodo (Mujo), ILDKPKI-ja në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) **Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.**
- b) **Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.**
- c) **Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.**
- c) **Nuk ka kryer deklarim të rremë.**
- d) **Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.**

Kështu që, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së saj personale dhe të familjarëve të saj”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, **kjo candidate gjendet në kushtet e lejimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.**



9. Më tej, ligjvënësi përcakton se **kushti i dytë për t'u verifikuar është ai i integritetit të kandidatëve.** Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit për kandidaten Vjosa Bodo (Mujo), në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016 dhe shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, referuar akteve të sjella nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar si dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme, në përmbajtje të të cilave njoftohen fakte në përputhje me ligjin për integritetin e figurës së znj. Vjosa Bodo, në zbatim të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si dhe të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, arrihet në përfundimin se kandidatja Vjosa Bodo **gjendet në kushtet e lejimit të kandidimit edhe për sa i përket verifikimit të integritetit.**

10. Përveç sa më sipër, **kushtet e tjera për t'u verifikuar** janë ato të përcaktuara në mënyrë eksplicite nga neni 237 pika 1 e ligjit 115/2016 që i referohet ‘kushteve ligjore të parashikuara në **ligjin për Gjykatën Kushtetuese** dhe në nenin 234, pika 1, të këtij ligji’. Në mënyrë taksative përcaktohen kushtet ligjore nga neni 7/a i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar duke përcaktuar në pikën 1 se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale; d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi; dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit”.

Në lidhje me kushtet e kandidimit të parashikuar nga pika 1 e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) me zotësi të plotë për të vepruar, ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1997- 2001 si Jurist, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, që sipas ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Po ashtu, nga aktet rezulton se kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike dhe as nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit si dhe nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Ndërsa siç është argumentuar në paragrafin e tetë, pakica konstaton njësoj me shumicën faktin se, kandidatja ka kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së saj personale dhe të familjarëve të saj, sipas ligjit. Për rrjedhojë sipas parashikimit të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja Vjosa Bodo (Mujo) **gjendet në kushtet e lejimit të kandidimit edhe për sa i përket verifikimit të kushteve ligjore të parashikuara në ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në nenin 234, pika 1, të ligjit nr. 115/2016.**

11. Për sa ka argumentuar më sipër, pakica vjen në përfundimin se duhej të vendosej lejimi i kandidimit të kandidatës Vjosa Bodo (Mujo), në vëndin vakant për gjyqtar në Gjykatën

Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.

ANËTARE/RELATORE

SAIDA DOLLANI

